



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosovo



**QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË**

**STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA**

**STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA**



Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë

Në bazë të nenit 9 dhe 13, të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë të datës 05.05.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve të Prishtinës në Prishtinë, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE KUFIZIMET E STUDENTËVE SHFRYTËZUES TË RESURSEVE TË QENDRËS

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen hollësitë, të drejta, obligimet dhe kufizimet e studentëve shfrytëzues të resurseve të Qendrës së Studentëve në Prishtinë.

Të drejtat e studentëve-shfrytëzuesve të resurseve të Qendrës së Studentëve

Neni 2

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës i gëzojnë të gjitha të drejtat që janë të parapara me Statutin e Qendrës së Studentëve dhe aktet tjera normative që janë në fuqi.

Neni 3

Studentët para se të vendosin që 'ti shfrytëzojnë resurset që ofron Qendra, kanë të drejtë të informohen me rregullat dhe rendin shtëpiak, kushtet e shfrytëzimit, të drejtat dhe përgjegjësit e tyre si shfrytëzues potencial të resurseve.

Neni 4

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës me rastin e vendosjes kanë të drejtë të pajisen me mjete që parashihen me Rregulloren për strehimin e studentëve në Qendrën e Studentëve.

Neni 5

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës me rastin e vendosjes kanë të drejtë të kontrollojnë dhomën dhe inventarin që ekziston në dhomë. Dëmtimet eventuale të mureve, dritareve, dritave, prizave dhe mungesën e inventarit, jo vetëm që ka të drejtë por studenti është i obliguar ti paraqet te personi zyrtar i konviktit me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike.

Neni 6

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës kanë të drejtën që në afat sa më të shkurtër të kërkojnë rregullimin ose sigurimin e mangësive të konstatuara me procesverbal, por jo më të gjatë se 48 orë nga konstatimi i mangësive.

Neni 7

Në qoftë se edhe pas 48 orëve nuk janë sanuar mangësitë, studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës kanë të drejtë të kërkojnë zëvendësimin e krevatit në ndonjërin nga dhomat tjera ku ekzistojnë kushtet optimale të parapara me Rregulloren.

Neni 8

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës pas vendosjes në konvikt kanë të drejtë të pranojnë vizita në dhomat e tyre vetëm në bazë të Rregullores mbi rendin shtëpiak.

Neni 9

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës kanë të drejtë të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën tjetër që ofron Qendra e që parashihet me Rregulloren për strehimin e studentëve në Qendrën e Studentëve konform rendit të caktuar shtëpiak.

Neni 10

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës furnizohen rregullisht me rrymë elektrike dhe ujë, ndërsa në sezonin e dimrit edhe me ngrohje.

Studentët furnizohen me ujë të ngrohët sipas orarit të caktuar, por jo më rrallë se tri herë brenda javës.

Orari për shfrytëzimin e ujit të ngrohët shpallet në tabelën e shpalljes të secilit konvikt.

Neni 11.

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës kanë të drejtë të kërkojnë pastrimin e hapësirave të përbashkëta nga udhëheqësi i konviktit në rastet kur hetojnë se pastrimi nuk është në nivel.

Kërkesa e tyre mund të paraqitet me shkrim në recepcion ose drejtpërdrejt te udhëheqësi i konviktit.

Neni 12

Në rast të krijimit të zhurmës nga bashkëbanuesit në dhomat e katit të tij ose të kateve të tjera, studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës kanë të drejtë të kërkojnë ndërhyrjen e receptionistit ose punëtorit të sigurimit për të siguruar qetësin e duhur në dhomat e tyre.

Nëse kërkesa e tyre për arsye të ndryshme nuk merret parasysh, atëherë studenti ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim udhëheqësit të konviktit.

Udhëheqësi i konviktit është i obliguar që ta shqyrtojë dhe sqarojë situatën brenda 24 orëve pas ushtrimit të ankesës.

Obligimet e studentëve-shfrytëzues të resurseve të Qendrës së Studentëve

Neni 13

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës janë të obliguar që në tërësi të respektojnë dispozitat e Statutit të Qendrës së Studentëve, Rregullores për strehimin e studentëve, rendin shtëpiak, si dhe vendimet tjera të cilat aprovohen nga organet e Qendrës së Studentëve dhe MASHT.



Neni 14

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës janë të obliguar që të mbajnë me vete ID-në, lejen për hyrje dhe banim në konvikt dhe të njëjtën ta deklarojnë me kërkesë të personit të autorizuar për identifikimin në hapësirën e Qendrës së Studentëve.

Neni 15

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës janë të obliguar të ruajnë pjesët e forta në dhomë, instalimet elektrike si dhe gjithë inventarin në dhomë dhe hapësirat e përbashkëta të konviktit.

Neni 16

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës janë të obliguar që t'i raportojnë dëmet eventuale jo vetëm në dhomat e tyre, por edhe në lokalet e përbashkëta, në lokalet ndihmëse në terrenet sportive apo Palestrën sportive. Raportimi për dëmin e konstatuar bëhet me gojë ose me shkrim në zyrën e udhëheqësit të konviktit ku banon.

Neni 17

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës të cilët me rastin e vendosjes në dhomë nuk kanë pas vërejtje, nuk iu pranohen reklamacionet e mëvonshme. Në raste të caktuara dëmi i konstatuar bie në ngarkesë të studentit i cili i shfrytëzon resurset e dhomës së caktuar.

Në rastet kur nuk mund të përcaktohet shkaktari i dëmit, kompensimi bëhet kolektivisht nga bashkëbanuesi-it në dhomën përkatëse.

Neni 18

Në rastet kur studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës nuk e raportojnë dëmin e shkaktuar në dhomë, në lokalet e përbashkëta, etj, atëherë dëmin e shkaktuar do ta kompensojnë banuesit e dhomës ose katit përkatës në mënyrë solidare ose proporcionalisht nga numri i bashkëbanueseve të dhomës, katit.

Në rastet kur bëhet kompensimi i dëmit të shkaktuar, studenti ka obligim të kërkojë dëftesë me shkrim nga arkëtari për lartësinë e pagesës së bërë.

Neni 19

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës në rast të lëshimit të mëhershëm të konviktit janë të obliguar që së paku 30 ditë më parë ta informojnë me shkrim personin e autorizuar në konvikt, në të kundërtën nuk i kthehet shuma e depozituar.

Neni 20

Në rastet kur studenti kërkon të lirohet nga e drejta e banimit, është i obliguar që dhomën ta dorëzojë të pastër dhe në gjendje të rregullt bashkë me tërë inventarin me të cilin është i ngarkuar sipas reversit.

Gjendjen faktike në vendin e ngjarjes e konstaton personi i autorizuar.

Pas kësaj procedure, studenti shkarkohet nga detyrimet dhe ai mund ta lëshojë konviktin.

Neni 21

Në rastet kur veprohet ndryshe nga ajo që parashihet me nenin 17 të kësaj Rregulloreje, reklamacionet e mëvonshme nuk pranohen dhe përgjegjësia bie mbi personin i cili nuk iu është përmbajtur normave të sanksionuara me këtë nen.

Qendra e Studentëve, personeli i konviktit nuk garanton sigurinë e gjësendeve në dhoma.

Ndalesat për shfrytëzuesit e resurseve të Qendrës së Studentëve

Neni 22

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së banimit dhe me qëllim të ruajtjes së rendit shtëpiak, studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës janë të obliguar që të iu përmbahen ndalesave si në vijim:

- Ndërrimi i dhomës, i katit apo i konviktit pa pëlqimin e personit të autorizuar.
- Dhënia e shtratit për shfrytëzim personit të tretë.
- Mbajtja e padeklaruar e personave tjerë në dhomë, (ilegalëve).
- Huazimi i përkohshëm apo i përhershëm gjatë një sezoni të banimit i lejes për hyrje në konvikt.
- Përdorimi i furnelave (reshove), hekurit për ngrohjen e ujit, nxehtëseve elektrike apo Kondicionerëve.
- Përdorimi i mjeteve radiodifuzive (Radio, TV, etj.), si dhe instrumenteve tjera muzikore me të cilat mund të prodhohet muzikë zhurmuese.
- Meremetimi, ndërrimi i vendit të ndërprerësve të rrymës, i prizave, dritareve apo zhvendosja e inventarit tjetër në dhomë apo në hapësirat e përbashkëta.
- Vendosja e posterëve, fotografive, tapicerive apo gozhdave nëpër muret e dhomës pa leje paraprake.
- Vendosja e shpalljeve, njoftimeve, afisheve apo publikimeve tjera pa marrjen e lejes paraprake nga personat e autorizuar në konvikt, gjegjësisht në Qendrën e Studentëve.

Neni 23

Studentëve shfrytëzues të resurseve të Qendrës nuk iu lejohej të ushtrojnë agjitacion dhe veprimtari politike në kompleksin e Qendrës së Studentëve.

Kjo nuk e ndalon angazhimin e studentëve në aktivitetet partiake jashtë Qendrës.

Neni 24

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës nuk i lejohej ushqimi në dhomë.

Në këtë rast banuesve në konvikt iu ndalohet:

- Zierja e gjellërave nëpër dhoma.
- Mbajtja në dritare i kavanozave me pemë e perime të konservuara apo shisheve me lëngje të ndryshme.
- Mbajtja dhe ruajtja e ushqimit të thatë në dhomë, etj.

Neni 25

Studentëve shfrytëzues të resurseve të Qendrës iu ndalohet hedhja e mbeturinave nga dritaret.

Banuesëve i'u ndalohet edhe larja e ndërresave, çarçafëve apo rrobave tjera në dhomë, si dhe tharja e tyre në dritaret e dhomës.

Neni 26

Studentëve iu ndalohet konsumimi i pijeve alkoolike, duhanit apo i substancave tjera narkotike në dhomat e tyre të banimit, apo në hapësirat tjera brenda Qendrës së Studentëve.

Studentëve të cilët janë nën ndikimin e substancave narkotike apo ata në gjendje të dehur, nuk iu lejohej hyrja në konviktet e Qendrës.

QENDRA E
STUDENTËVE
DITË
17.07.2019

Neni 27

Në rastet kur studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës nuk iu përmbahen ndalesave të përcaktuara me Rregullore, për pasojë kanë ndërmarrjen e masave përkatëse disiplinore si në vijim:

1. **Vërejtje me gojë.**
2. **Vërejtje me shkrim.**
3. **Parapërfjashtim dhe**
4. **Përfjashtim nga konvikti.**

Vendimin për shqiptimin e masës disiplinore, **vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe parapërfjashtim**, e merr udhëheqësi i konviktit.

Vendimin për shqiptimin e masës, **përfjashtim nga konvikti**, e merr udhëheqësi i konviktit në bashkëpunim me drejtorin e strehimit.

Për secilën masë të shqiptuar duhet të udhëhiqet dhe të mbahet evidencë e rregullt.

Për rastet vërejtje me shkrim, parapërfjashtim, përkatësisht përfjashtim nga konvikti, studentit duhet t'i dorëzohet Vendimi me shkrim.

Vendimi duhet të përmbajë edhe këshillën juridik për mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankesës.

Neni 28

Kundër vendimit për shqiptimin e masës së caktuar disiplinore, studenti ka të drejtë në ankesë për rishqyrtimin e vendimit.

Kërkesa e parashtruar për rishqyrtimin e vendimit duhet të shoqërohet me provat përkatëse që shkojnë në favor të palës së dëmtuar.

Ankesa i drejtohet Komisionit Qendror në nivel të Qendrës së Studentëve.

Komisionin Qendror e formon Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve në fillim të sezonit të strehimit dhe ka mandat një vjeçar.

Vendimi i Komisionit Qendror është definitiv.

Mbi shqiptimin e masës, studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës në rast të lëshimit të mëhershëm të konviktit janë të obliguar që së paku 30 ditë më parë ta informojnë me shkrim personin e autorizuar në konvikt.

Në raste të tilla mundet, por nuk është e domosdoshme të raportohet për shkaqet e lëshimit të konviktit. Në raste të tilla, shfrytëzuesi i së drejtës së banimit nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës së mbetur të pagesës.

Ushtrimi i ankesës për rishqyrtimin e vendimit nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit për përfjashtimin e studentit nga konvikti.

Neni 29

Në rastet kur studenti kërkon më herët ta ndërpret shfrytëzimin e të drejtës së banimit, është i obliguar që dhomën ta dorëzojë të pastër dhe në gjendje të rregullt bashkë me tërë inventarin me të cilin është i ngarkuar sipas reversit.

Gjendjen faktike në vendin e ngjarjes e konstaton personi i autorizuar.

Pas kësaj procedure, studenti shkarkohet nga detyrimet dhe ai mund ta lëshojë konviktin.

Neni 30

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi të drejtat, obligimet dhe kufizimet e studentëve-shfrytëzues të resurseve të Qendrës nr.113 të datës 29.03.2017.

Neni 30
Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

Prishtinë
29.12.2022

Drejtori i përgjithshëm
Fatmir Sfishta

